



Nr. 1810/295Prot

Tiranë më 30.06.2026

Drejtuar: Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Në vëmendje: Strukturës përgjegjëse për konsultimin publik të Projektvendimit "Për miratimin e Dokumentit Politik për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2026–2030"

Për Dijeni: **Këshillit të Investimeve**

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Komisionit Parlamentar për Integrimin European

Këshillit të Investimeve

Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri

Drejtorisë së Përgjithshme për Tregun e Brendshëm, Industrinë, Sipërmarrjen dhe NVM-të (DG GROW) – Komisioni European

Lënda: Komente dhe sugjerime mbi Projektvendimin “Për miratimin e Dokumentit Politik për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2026–2030” dhe Relacionin Shoqërues

Të nderuar,

AREA vlerëson pozitivisht nismën për hartimin dhe miratimin e Dokumentit Politik për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2026–2030, i cili është në përputhje me objektivat e integritit european,

Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

Website: www.areasso.org

Email: info@areasso.org

Tel: +355 (0)68 60 61 210



Strategjinë e Bashkimit European për NVM-të dhe nevojën për rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare.

Vlerësojmë se dokumenti adreson në mënyrë të drejtë një sërë sfidash me të cilat përballet biznesi shqiptar, përfshirë produktivitetin, aksesin në financim, digjitalizimin, inovacionin, integrimin në tregjet europiane dhe tranzicionin e gjelbër.

Në frymën e konsultimit publik dhe me synimin për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të dokumentit, paraqesim komentet dhe sugjerimet e mëposhtme.

I. Komente dhe sugjerime mbi Dokumentin Politik për NVM 2026–2030

1. Forcimi i parimit të sigurisë juridike

Dokumenti identifikon në mënyrë korrekte problematikat që lidhen me fragmentimin institucional dhe mbivendosjen e kompetencave ndërmjet institucioneve.

Megjithatë, vlerësojmë se mungon një referencë e qartë ndaj sigurisë juridike si një nga kushtet themelore për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe të investimeve private.

Sugjerojmë që në seksionin e vizionit dhe objektivave strategjikë të përfshihet formulimi:

“Politikat publike për zhvillimin e NVM-ve duhet të mbështeten në parimet e sigurisë juridike, mbrojtjes së investimeve, parashikueshmërisë rregullatore dhe respektimit të të drejtave të fituara ligjërisht.”

Ky parim është thelbësor për klimën e biznesit dhe në përputhje me praktikën më të mira europiane.

2. Stabiliteti rregullator

Një nga shqetësimet kryesore të sipërmarrjes në Shqipëri lidhet me ndryshimet e shpeshta të kuadrit rregullator dhe interpretimet e ndryshme të legjislacionit nga institucione të ndryshme.

Sugjerojmë shtimin e objektivit:

“Sigurimi i një kuadri rregullator të qëndrueshëm, transparent dhe të parashikueshëm për biznesin, duke minimizuar ndryshimet e papritura dhe barrët administrative të panevojshme.”

3. Konsultimi i biznesit

Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

Website: www.areasso.org

Email: info@areasso.org

Tel: +355 (0)68 60 61 210



Dokumenti përmend bashkëpunimin institucional, por nuk përcakton në mënyrë të qartë rolin e organizatave përfaqësuese të biznesit.

Sugjerorjmë përfshirjen e formulimit:

“Përfshirja sistematike dhe e strukturuar e organizatave përfaqësuese të biznesit në procesin e hartimit, zbatimit dhe rishikimit të politikave që ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë ekonomike.”

4. Tranzicioni i gjelbër

AREA mbështet objektivat që lidhen me tranzicionin e gjelbër dhe ekonominë qarkulluese.

Megjithatë, rekomandojmë që dokumenti të sqarojë se masat në këtë drejtim duhet të zbatohen në mënyrë proporcionale dhe pa krijuar barrë të panevojshme për ndërmarrjet.

Sugjerorjmë formulimin:

“Masat që lidhen me tranzicionin e gjelbër duhet të zbatohen në mënyrë proporcionale, duke shmangur barrë të panevojshme administrative dhe financiare për NVM-të.”

5. Mbështetja e investimeve produktive afatgjata

Dokumenti trajton çështjen e aksesit në financim, por mund të përforcohet më tej përmes një referimi më të qartë ndaj investimeve afatgjata.

Sugjerorjmë përfshirjen e formulimit:

“Mbështetja e investimeve produktive afatgjata në sektorë strategjikë, përfshirë energjinë, industrinë, turizmin dhe teknologjinë.”

II. Komente dhe sugjerime mbi Relacionin Shoqërues

1. Siguria juridike dhe klima e investimeve

Relacioni identifikon problematikat e fragmentimit institucional dhe koordinimit të dobët, por nuk trajton ndikimin që pasiguria juridike ka mbi investimet dhe zhvillimin e biznesit.

Sugjerorjmë shtimin e formulimit:

Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

Website: www.areasso.org

Email: info@areasso.org

Tel: +355 (0)68 60 61 210



“Një nga faktorët që ndikon drejtpërdrejt në konkurrueshmërinë e NVM-ve është siguria juridike dhe parashikueshmëria e kuadrit rregullator, të cilat ndikojnë në vendimmarrjen investuese dhe në aksesin në financim.”

2. Mbrojtja e investimeve ekzistuese

Relacioni fokusohet në konkurrueshmërinë dhe produktivitetin, por nuk trajton mjaftueshëm rëndësinë e ruajtjes së investimeve ekzistuese.

Sugjerojmë shtimin e formulimit:

“Politikat për NVM-të duhet të kontribuojnë gjithashtu në ruajtjen e investimeve ekzistuese dhe në forcimin e besimit të investitorëve vendas dhe të huaj.”

3. Koordinimi ndërinstytucional

Duke qenë se vetë relacioni identifikon fragmentimin institucional si problem, rekomandojmë forcimin e referencave mbi koordinimin ndërmjet institucioneve.

Sugjerojmë formulimin:

“Institucionet publike duhet të garantojnë interpretim dhe zbatim të unifikuar të legjislacionit, në mënyrë që bizneset të mos përballen me kërkesa kontradiktore nga autoritete të ndryshme.”

4. Tranzicioni i gjelbër dhe konkurrueshmëria

Rekomandojmë që të theksohet se:

“Politikat e tranzicionit të gjelbër duhet të shoqërohen me masa mbështetëse financiare dhe teknike, në mënyrë që të mos cenojnë konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve.”

5. Parimi i proporcionalitetit

Sugjerojmë përfshirjen e një reference të qartë ndaj parimit të proporcionalitetit:

“Çdo masë rregullatore që prek NVM-të duhet të respektojë parimin e proporcionalitetit dhe të shmangë krijimin e barrëve të panevojshme administrative ose financiare.”

Përfundim

Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

Website: www.areasso.org

Email: info@areasso.org

Tel: +355 (0)68 60 61 210



AREA mbështet miratimin e Projektvendimit dhe të Dokumentit Politik për NVM 2026–2030 dhe vlerëson përpjekjet e ndërmarra për harmonizimin e politikave kombëtare me standardet dhe praktikën e Bashkimit Europian.

Megjithatë, vlerësojmë se përfshirja e elementeve të sipërpërmendura do të kontribuonte në forcimin e sigurisë juridike, stabilitetit rregullator, mbrojtjes së investimeve dhe përmirësimit të klimës së biznesit në Shqipëri.

AREA do të vlerësonte marrjen në konsideratë të komenteve dhe sugjerimeve të mësipërme, si dhe një reflektim nga ana e institucioneve përgjegjëse dhe e Këshillit të Investimeve mbi trajtimin e tyre gjatë procesit të mëtejshëm të konsultimit dhe miratimit të dokumentit.

Me respekt,

SHOQATA "AREA"

Anita SHUSHKU

(
Kryetare e Bordit Ekzekutiv



Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

Website: www.areasso.org

Email: info@areasso.org

Tel: +355 (0)68 60 61 210